PARLAMENTI STUDENTOR

Raporti i punës së Parlamentit Studentor të UUHP-së 2020-2021

11.01.2021

Parlamenti Studentor e nisi këtë vit me vizitën te humanisti, hoxha i nderuar, z. Halil Kastrati. Kjo vizitë u bë me qëllim të urimit për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve. Për punën madhështore dhe humane të humanistit, për angazhimin e pashoq anekënd trojeve shqiptare, Parlamenti i ndau një mirënjohje si shenjë falënderimi.

22.01.2021

THEMELOHET "KONFERENCA E PARLAMENTEVE STUDENTORE" - KPS

Parlamentet Studentore të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës, si organet më të larta përfaqësuese të studentëve në universitetet përkatëse, vendosën të themelojnë "Konferencën e Parlamenteve Studentore", me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe aktivizmit studentor në Republikën e Kosovës.
Parlamenti Studentor i Universitetit " Ukshin Hoti " u zotua që do të punojë dhe do të përkujdeset maksimalisht që kjo konferencë të jetë sa më produktive për të mirën e studentëve të Republikës së Kosovës. Në këtë takim PS-UPz, u përfaqësua nga kryetari Milot Krasniqi.

Takimi i parë joformal u mbajt në Senatin e Universitetit të Prishtinës, ku u diskutua për formimin formal të "Konferencës së Parlamenteve Studentore", vendosjen e kontaktit institucional, njoftimin mbi punën e Parlamenteve Studentore në universitetet përkatëse si dhe u trajtuan çështje të rëndësishme për studentët në nivel rajonal dhe shtetëror.

11.03.2021

Parlamenti Studentor i UHZ-së ishte nikoqir i takimit të radhës së Konferencës së Parlamenteve Studentore

Takimi III-të formal u mbajt në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Aty u diskutua për punën e deritanishme të Parlamenteve, fillimin e semestrit veror, njoftimin mbi punën e Parlamenteve Studentore në universitetet përkatëse si dhe u trajtuan çështje të rëndësishme për studentët në nivel qendror.

21.03.2021

Parlamenti Studentor merr pjese ne aktivitetin per diten boterore te sindomes down
A po m'sheh?
21 Mars, Dita Botërore e Sindromës Down

21.03.2021

Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Për nder të ditës Ndërkombëtare të Pyjeve studentët e universitetit tanë të prirë nga kryetari Parlamentit Studentor Milot Krasniqi kanë realizuar aktivitetin për mbjellje të fidaneve në oborrin e universitetit.

06.04.2021

Në 32 vjetorin e rënies së heroit të kombit prof. Xhemajli Berishës, Parlamenti Studentor përkujton me krenari veprimtarinë e tij.

Me humbjen e tij, nuk humbi vetëm familja e tij një djalë trim, humbëm edhe ne, një profesor të mrekullueshëm.

09.04.2021

Më 9 Prill 2008 u miratua Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi më 15 Qershor 2008.

Për nder të kësaj dite, studentët e Fakultetit Juridik, realizuan një aktivitet simbolik. Përmes fotografive, studentët pjesëmarrës të projektit "Klinika Juridike Penale me raste reale", përçuan informacione te qytetarët, për të drejtat e tyre në sistemin gjyqësor.

13.04.2021

Për nder të fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit, Parlamenti Studentor ishte për vizitë në Këshillin e Bashkësisë Islame në Prizren. Në Këshill, u prit nga kryetari i Bashkësisë Mr. Besim ef. Berisha.

Parlamenti Studentor së bashku me kryetarin e Këshillit, patën një takim tejet vëllazëror.

17.06.2021

Për nder të ditëlindjes së 78 të profesor Ukshin Hotit, Z.Arianit Berisha ka mbajtur një fjalim.Fjalimin nisi duke cekur rëndësinë e profesor Ushkin Hoti-it dhe shtoi këto fjalë:

"Fatkeqësisht, sot profesorin e kemi prezent vetëm në bronz, por edhe kjo duhet të jetë e mjaftueshme që të gjithë ne të ecim në rrugën e tij.

Konsideroj se veprimtaria e secilit që ndodhet në këtë sallë lidhet drejtëpërsëdrejti me zhvillimin e këtij Universiteti, prandaj ju bëj thirrje të gjithëve që të punojmë me ndershmëri që këtë tempull të dijës ta radhisim në mesin e Universiteteve me famë botërore, sepse para se të jetë nder e privilegj emri që mbanë Universiteti ynë, mbi të gjitha është një përgjegjësi e madhe që rëndon mbi supet e te gjithë neve, që ta përfaqësojmë atë në mënyrë të denjë.

Profesor, kudo që të jesh, urime ditëlindja! Kolosët si ti kanë veç ditëlindje.

Ju faleminderit!"